



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

**THIRRJE PËR APLIKIME
PËR MBËSHTETJEN E STUDIMEVE TË DOKTORATËS
(Kohorta I-rë 2025)**

15 Korrik, 2025

I. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË MBËSHTETJES SË STUDIMEVE TË DOKTORATËS

Kjo është një thirrje për mbështetjen me fonde të projekteve të studimeve të doktoratës, financuar nga “Programi i Kërkimit Shkencor”, administruar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit - AKKSHI”, për vitin 2025.

Objektivat e “Programit të Doktoratës” janë:

- a) Të nxisë dhe të lehtësojë kërkimin shkencor gjatë studimeve të doktoratës, për transformimin e cilësisë dhe sasisë së kërkimit shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë.
- b) Të nxisë kërkime që adresojnë sfidat e zhvillimit teknologjik, të cilat zhvillohen në bashkëpunim me industrinë, që çojnë në inovacion dhe startup-e.
- c) Të nxisë dhe të fuqizojë kulturën e bashkëpunimit me diasporën akademike në kërkim shkencor dhe krijimin e njohurive të reja, thelbësore për arsimin e lartë dhe ekselencën.
- d) Të lehtësojë kërkime shkencore cilësore nëpërmjet zhvillimit të proceseve kërkimore në bashkëpunim me universitetet e vendeve të BE, SHBA, Kanadasë.

II. BAZA LIGJORE

Kuadri rregullator për këtë program financimi të AKKSHI-së është përcaktuar në Ligjin Nr. 80 , datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 12, pika 5.

Vendimin Nr.607, datë 31.08.2016 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit”, pika 9/d.

Thirrja është në përputhje me Programin Vjetor të Punës të AKKSHI-së për vitin 2025: “Vendimi i Bordit të Administrimit të AKKSHI-së nr. 2 datë, 13.02.2025 “Për miratimin e detajimit dhe rialokimit të buxhetit të AKKSHI-së, të vitit 2005 sipas programeve dhe aktiviteteve mbështetëse të kërkimit shkencor”.

III. FUSHAT PRIORITARE

Thirrja mbulon fushat e kërkimit shkencor:

- Biodiversiteti dhe Mjedisi
- Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia
- Shëndetësia dhe shkencat mjekësore
- Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit
- Shkencat Sociale dhe Albanologjike
- Uji dhe Energjia

Në përputhje me fushat e mësipërme, do të kenë prioritet projektet e studimeve të doktoratës që adresojnë tematika prioritare të zhvillimit social ekonomik të vendit të cilat zhvillohen si fusha ndësidisiplinare, si psh:

- Big Data; Machine Learning & Data Sciences; Inteligjence Artificiale; Qytetet Smart.

- Teknologjitë smart për Bujqësinë dhe Industrinë e ushqimit; Potenciali lokal bujqësor në mbështetje të turizmit; Agroturizmi dhe qëndrueshmëria mjedisore.
- Përdorimi i teknologjisë 3D për të rikrijuar vende arkeologjike historike; Zbulimi i të dhënave historike me inteligjencë artificiale.
- Ndikimi i ndryshimeve klimatike në burimet ujore dhe prodhimin e energjisë; Qasjet inovative për reduktimin e humbjeve të ujit në prodhimin e energjisë, etj.
- E drejta dhe mjedisi; E drejta dhe teknologjia etj

IV. KRITERET E PRANUESHMËRISË PËR FINANCIMIN E STUDIMEVE TË DOKTORATËS

Në kuadër të programit të mbështetjes së studimeve të doktoratës, kanë të drejtë të aplikojnë për financim:

1. Të gjithë kandidatët që janë pranuar nga një Institucion i Arsimit të Lartë¹ (publik ose privat) për të ndjekur studimet e doktoratës gjatë vitit akademik 2024-2025;
2. Kandidadi është pjesë e stafit akademik të një Institucioni të Arsimit të Lartë;
3. Fusha (tema/projekti i përzgjedhur) e studimit/kërkimit përputhet me fushat prioritare të përcaktuara në këtë kohortë;
4. Aplikimi respekton kushtet, kriteret dhe formatin standard të aplikimit të publikuara nga AKKSHI;
5. Projekti i paraqitur për financim të jetë i miratuar nga udhëheqësi i kandidatit në procesin e studimeve të doktoratës.

Nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga kohorta e parë e programit të “Dokoratës” :

1. Kandidatët që kanë përfituar financim nga një skemë/program financimi i IAL, AKKSHI-se, ose një financues tjetër kombëtar dhe ndërkombëtar, për të njëjtin projekt.
2. Kandidadët të cilët kanë filluar studimet e doktoratës përpara vitit akademik 2024-2025.

V. REGJISTRIMI PËR APLIKIM

Kategoria e kandidatëve: Kandidatët që janë pranuar në programin e ciklit të tretë të studimeve të doktoratës nga një IAL (publike ose private) në vitin akademik 2024-2025 mund të aplikojnë për të përfituar nga programi direkt në AKKSHI sipas formës së aplikimit dhe udhëzimeve të përcaktuara në “Udhëzues për Programin e Mbështetjes së Doktoratës”.

VI. KOHËZGJATJA DHE BUXHETI

1. Kohëzgjatja e financimit është për një periudhë jo më pak se 1 (një) vit dhe jo më shumë se 5 (pesë) vjet ose ashtu siç është përcaktuar në rregulloren e IAL-së për kohëzgjatjen e studimeve të doktoratës.
2. Buxheti në dispozicion të kësaj thirrje është buxheti i AKKSHI-së për vitin 2025, në zërin buxhetor “Fonde për projekte për studime të doktoratës”.

¹ I përcaktuara si IAL në Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

3. Vlera maksimale e financimit për të gjitha vitet do të jetë deri në **500,000 lekë**.
4. Fondi për këtë thirrje mbulon zërat e shpenzimeve² si më poshtë :
 - i. Tarifa për analiza laboratorike brenda ose jashtë vendit;
 - ii. Blerje e literaturës;
 - iii. Abonime në libra ose revista shkencore për qëllimin dhe periudhën e kryerjes së studimeve;
 - iv. Blerje të programeve (software), në funksion të projektit të studimeve të doktoratës;
 - v. Publikime³ në revista shkencore me faktor të lartë impakti (tarifën e publikimeve);
 - vi. Shpenzime mobiliteti (akomodim, dieta dhe transport) të doktorantit të argumentuara në metodologjinë e studimit ose të levizjes së tyre në universitete ku zhvillohen disa procese kërkimore ose seminare, trajnime dhe konferenca shkencore të lidhura me temën e studimit⁴.
 - vii. Shpenzime mobiliteti (akomodim, dieta dhe transport) për një udhëheqës të diasporës.
 - viii. Tarifë për pjesmarrje në konferenca shkencore ku trajtohen çështje të temës së studimit⁵

VII. KRITERE TË PËRGJITHËSHME PËR APLIKIM DHE VLERËSIM

Përfitimi i mbështetjes financiare nga programi i studimeve të doktoratës, realizohet nëpërmjet një procesi vlerësimi administrativ dhe teknik i përcaktuar në “Udhëzuesin për Programin e Mbështetjes së Doktoratës”. Ky proces mbështetet në kriteret për aplikim (administrativ) dhe vlerësim teknik.

1. Kriteret për aplikim përfshijnë:
 - a. Kandidati është pranuar të ndjekë studimet e doktoratës, nga një IAL⁶;
 - b. Kandidati është pjesë e stafit akademik të një IAL, dhe ka zhvilluar temën (tezën) dhe metodologjinë e studimit.
 - c. Kandidati paraqet një projektpropozim ku janë argumentuar qartë zërat e buxhetit që kërkohen të financohen, mbështetur në metodologjinë e studimit;
 - d. Studimet e doktoratës janë në përputhje me një nga objektivat e programit, cituar në pikën I të kësaj “Thirrje”.
 - e. Popozimi të përmbajë metodologjinë e kërkimit shkencor të miratuar nga udhëheqësi, aktivitetet kërkimore që mbështesin këtë metodologji si dhe buxhetin përkatës sipas zerave.
2. Vlerësimi i projektit bazohet në kriteret si më poshtë:
 - a. Studimi bën pjesë në fushat prioritare të kërkimit shkencor
 - b. Projekti i propozuar ka objektiva të qarta kërkimore, në përputhje me objektivat e “Thirrjes”;
 - c. Metodologjia e studimit ndërthur dy ose me shume disiplina;
 - d. Metodologjia dhe instrumentat e kërkimit paraqesin inovacion dhe origjinalitet (sjellin ide të reja apo metoda të reja kërkimore?).
 - e. Studimi ka potencial për ndikim në nivel shkencor, shoqëror, ekonomik apo teknologjik.
 - f. Propozimi ka një strategji të qartë për përhapjen dhe shfrytëzimin e rezultateve (publikime,

² Për detaje shikoni formën e buxhetit dhe udhëzuesin;

³ Publikimi duhet të ketë lidhje me aktivitetin kërkimor i cili mbështetet me këtë grant

⁴ Studime ne terren, pune laboratorike, ose pjesmarrje ne aktivitete te propozuara ne projektin qe do te financohet

⁵ Kriteret per pjesmarrje ne konferenca do te parashikohen ne udhëzuesin perkates

⁶ Te specifikohet “Rregullorja e doktoraturave”

konferenca, patentë, ndikim në politika, etj)

g. Studimi disponon burimet e nevojshme për tu realizuar (infrastrukturë, pajisje, njohuri)

h. Propozimi ka një justifikim të qartë të kostove të kërkuara;

3. Në për zgjedhjen e projektit për financim, AKKSHI i përmbahet parimit të konkureshmërisë.

VIII. DO TË KENË PËRPARËSI

1. Projekte të kërkimit shkencor të cilat **adresojnë fushat prioritare të cituara në pikën III.**
2. Projekte të kërkimit shkencor që zhvillohen në kuadër të studimeve doktorale **në bashkëpunim me industrinë/biznesin.**
3. Projekte të kërkimit shkencor që zhvillohen në kuadër të studimeve doktorale me **pjesmarrjen e disaporës akademike;**
4. Projekte të kërkimit shkencor që zhvillohen në kuadër të studimeve doktorale, **ku një pjesë e aktivitetit kërkimor (analiza, vrojtime, konferenca etj) zhvillohen në universitete të vendeve të BE.**

IX. DORËZIMI I APLIKIMIT

1. Dokumentacioni i kërkuar:
 - i. Letër motivimi dhe cv e kandidatit
 - ii. Vërtetimi IAL-së për pranimin e kandidatit në studimet e doktoratës në vitin akademik 2024-2025.
 - iii. Forma e Aplikimit (Aneks 1) “Projekti kërkimor (metodologjia, aktivitetet, buxheti) i miratuar (firmosur) nga udhëheqësi i kerkimit shkencor”
 - iv. Forma e Propozimit Financiar (Aneks 2 sheet 2.1 dhe sheet 2.2) .
2. Dokumentacioni i mësipërm dorëzohet në AKKSHI në 2 kopje të printuar dhe digjitale.
3. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin përmes postës zyrtare, në adresën: AKKSHI, Rruga “Naim Frashëri”, Nr.37, Tiranë, Shqipëri.
4. Afati i fundit për depozitim të aplikimeve në AKKSHI është data 15/10/2025.

X. INFORMACIONE TË TJERA

1. Aplikantët duhet t'i referohen udhëzuesit përkatës për “Programi për mbështetjen e Studimeve të Doktoratës” ku do të gjejnë formën e aplikimit, udhëzime dhe detaje specifike lidhur me plotësimin e dokumentacionit për aplikim.
2. Individët të cilët janë pranuar si studentë të ciklit të tretë të studimeve të doktoratës para vitit akademik 2024-2025 nuk janë përfitues të kohortës së parë të këtij programi.
3. Për sqarime më të hollësishme, lidhur me programin ose me procedurat e aplikimit, të interesuarit mund të drejtohen pranë Drejtorisë së Programeve Kombëtare në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ose me e-mail në adresën: gentiana.spahiu@nasri.gov.al deri në datën 30/09/2025.
4. Udhëzuesit dhe Format e aplikimit mund t'i gjeni në faqen zyrtare të AKKSHI: <http://www.nasri.gov.al>.
5. Kalendari i Thirrjes

Data e publikimit të Thirrjes për aplikim	15/07/2025
Datat kur AKKSHI do të jep sqarime ose do të organizojë seancë informative për aplikuesit e interesuar	15/07/2025 - 30/09/2025
Afati i fundit për pyetje lidhur me programin	30.09.2025
Data për dorëzimin e dokumentacionit të propozimeve	15/10/2025
Vlerësimi i propozimeve	30/11/2025
Shpallja e fitueseve	15/12/2025